



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 43/2021 (JR)  
Datë 29.07.2021

Vendim nr. 34 (JR)  
Datë 26.07.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.07.2023, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Willem Brouwer, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 395, datë 08.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në zbatim të neneve 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilëve ka rezultuar:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përfundim të veprimeve verifikuese, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dërgoi në Komision raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë dhe mosdeklarime*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procedurave të kryera, ka dërguar në Komision raportin e përditësuar<sup>2</sup>, ku nisur nga të dhënat e siguruara nga institucionet verifikuese, ka konstatuar *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gentian S. Stoja.

---

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentian Stoja, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

2.3. KLP-ja, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga Prokuroria e Përgjithshme e Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe, në përfundim, ka dërguar pranë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Pas administrimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, Komisioni kreu hetimin e plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke marrë vendimin nr. 395, datë 08.06.2021.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 395, datë 08.06.2021, Komisioni vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Stoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë*. Ky vendim u bazua në nenin 58, pika 1, germa “c” dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet e arritura për secilin kriter rivlerësimi, si më poshtë.

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë të paplota dhe të pamjaftueshme, pasi në to nuk gjejnë pasqyrim të gjitha pasuritë e akumuluar ndërvite, burimi i krijimit të tyre apo të drejtat reale mbi to. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat nga dhurimi, të deklaruara prej tij dhe personit të lidhur në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, si dhe të drejta reale mbi të ardhurat nga qiraja, të cilat nuk janë në koherencë me deklaratimet periodike vjetore. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me gjendjen *cash*, nuk përputhen e nuk vijnë në harmoni me deklaratimet periodike vjetore të tij.

Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë duke paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe nuk arriti të bindë Komisionin për të kundërtën, duke u ndodhur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Sjelljet dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë: (a) dhuratë në shumën 50.000 euro; dhe (b) 4.440.000 lekë të ardhura nga qiratë, janë të pabesueshme dhe për to nuk u provua burimi i krijimit sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe as kthimi i tyre. Deklarimet e subjektit nuk gjenin mbështetje në ndonjë deklarament periodik vjetor dhe mbetën në kontekstin deklarativ edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Këto sjellje, në vlerësim të Komisionit, krijuan bindjen se subjekti i rivlerësimit ndodhet para një deklarimi të rremë në vitin 2009, ose para fshehjes së pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, për rrjedhojë, u konsideruan të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka vepruar në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>3</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 14.04.2021, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja”.

- Për kriterin e kontrollit të figurës:

Konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës. Nga rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për këtë kriter, nuk rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni vlerëson se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikave 2 apo 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por se konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen nga Komisioni, në vlerësimin në tërësi të çështjes, lidhur me rivlerësimin e subjektit Gentian Stoja, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

Në përfundim, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

### **III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja**

5. Ndaj vendimit nr. 395, datë 08.06.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet të cilit i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin në themel të fakteve e provave, si dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe me natyrë procedurale dhe shkaqe lidhur me themelin e çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
6. Shkaqet e ankimit që i përkasin natyrës procedurale lidhur me procesin e rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në sa vijon.

**6.1.** Asnjë provë e administruar nga Komisioni nuk dëshmon apo provon se subjekti i rivlerësimit kishte pasuri të fshehura, deklarime të rreme, burime të paligjshme të pasurisë, pasuri më të madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, e që ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për të zbatuar parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**6.2.** Zhvillimi i një hetimi sipërfaqësor, paragjykes dhe me një vendim të paracaktuar për të shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, cenon të drejtat për një proces të rregullt ligjor nën dritën e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNJ”). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt nga Komisioni në këtë rast, duke mbajtur në konsideratë dhe këtë fakt, nuk përmbush standardin e gjyqimit të çështjes në mënyrë të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor,

parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat të Njeriut (në vijim “KEDNj”).

**6.3.** Komisioni nuk mori në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, nuk dha asnjë shpjegim për vlerën e tyre provuese gjatë seancës dëgjimore dhe, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit për çdo pretendim të subjektit të rivlerësimit, u mjaftua me shprehjen *se do të arsyetohej në vendimin përfundimtar*, duke vënë në dyshim serioz për shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe të një vendimi të paragjykuar e të paracaktuar.

**6.4.** Asnjë nga provat e dorëzuara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk iu nënshtrua debatit gjyqësor, duke ua lënë vendin “surprizave” në vlerësimin e tyre në vendim, gjë që e bën procesin e cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe nën dritën e KEDNj-së. Është cenuar neni 8 i KEDNj-së dhe jurisprudenca e konsoliduar e GjEDNj-së, pasi Komisioni ka hetuar çdo person, ndonëse nuk kanë qenë në rrethin e personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur.

**7.** Shkaqet e ankimit mbi themelin e çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten si më poshtë.

**7.1.** *Lidhur me kursimet cash, në vlerën 4.440.000 lekë*

**7.1.1.** Shuma e deklaruar saktësisht dhe me vërtetësi nga bashkëshortja në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009, nuk buron nga të ardhura të përfituara gjatë martesës dhe aq më pak gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror. Kjo shumë u përket prindërve të bashkëshortes dhe nuk i është dhuruar kësaj të fundit, por i është lënë në ruajtje. Mosndërrhyrja e subjektit të rivlerësimit në marrëdhënien prind - fëmijë, nuk mund ta penalizojë atë në procesin e rivlerësimit.

**7.1.2.** Në kushtet kur shuma është kthyer nga bashkëshortja te prindërit e saj në vitin 2014, fakt i deklaruar përpara organit kompetent, ILDKPKI-së, më 26.01.2016, si dhe duke mos shërbyer si burim krijimi për ndonjë pasuri apo investim për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten, apo duke mos gjeneruar apo përfituar interesa prej saj, nuk është konsideruar nga subjekti si detyrim për ta deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**7.1.3.** Mundësia financiare e prindërve të bashkëshortes për krijimin e shumave, si dhe e drejta e tyre për t’ia dhënë bashkëshortes t’i përdorte, përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor për të justifikuar barrën e provës, në një kohë kur vullneti i prindërve të bashkëshortes është shprehur në deklaratën e nënshkruar dhe dorëzuar në ILDKPKI përpara miratimit dhe ndryshimeve kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, çka bën të besueshme deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.

**7.1.4.** Përveçse konkluzioneve të pabaza dhe alogjike, Komisioni nuk dha asnjë shpjegim se përse provat, argumentet ligjore dhe financiare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk qëndronin. Në mënyrë paradoksale, Komisioni nuk ka marrë parasysh dy akte shkresore të depozituara në cilësinë e provës, të cilat qartazi dëshmojnë faktin se apartamenti në Durrës është përdorur nga prindërit e bashkëshortes, ka pasur konsum të energjisë elektrike dhe ujit. Ky apartament nuk është lënë asnjëherë me qira për periudha mbi 1- (një) vjeçare, madje as 6-

(gjashtë) mujore, çka do ta detyronte pronarin e tij të lidhte kontratë sipas nenit 803, paragrafi 4 i Kodit Civil.

**7.1.5.** Konstatimi i Komisionit se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten deklarative dhe të paprovuara në ndonjë formë ligjore apo nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore, është i padrejtë. Komisioni nuk arriti të analizojë drejt faktet dhe rrethanat, të cilat në asnjë rast nuk kanë qenë kontradiktore, të paqarta apo jokoherente me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përgjatë viteve, si dhe në dokumentin e vlerësimit. Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë më se të mjaftueshme për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës.

**7.1.6.** Në kuptim të dispozitave kushtetuese, nenit Ç, pika 1 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudence të Kolegjit, objekti i hetimit dhe vlerësimit të pasurisë materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe krahasimi i saj me deklaratimet periodike vjetore, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaratim të pasaktë, nuk ka fshehur të pasurisë dhe ka pasuri të krijuar nga burime të ligjshme.

**7.1.7.** I pavend, kontradiktor dhe jokoherent është qëndrimi i Komisionit lidhur me shumën 4.440.000 lekë, që ka si burim të ardhurat nga qiratë, duke i konsideruar ato si të pabesueshme, të mbetura në kontekstin deklarativ, dhe duke vlerësuar sjelljet e subjektit në kushtet e deklarimit të rremë në vitin 2009 ose fshehjes në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, për rrjedhojë, të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**7.1.8.** Në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çdo provë vlerësohet në unitet me të tjerat pasi asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundërt nuk do të kishte çmuarje të provave. Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të çmuarjes së provave duke injoruar të gjitha shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit, mbi të cilat duhej të arsyetonte.

## **7.2. Lidhur me të ardhurat cash në vlerën 50.000 euro, në formë dhurate**

**7.2.1.** Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, i cili ka sqaruar qartë burimin e shumave të dhuruara dhe ka depozituar dokumentacion ligjor nga autoritetet e huaja, greke dhe italiane, në lidhje me burimin e krijimit të tyre për periudhën kur janë dhuruar.

**7.2.2.** Kjo shumë e përfituar nga marrëdhënie prind-vajzë dhe motër-motër, është deklaruar në mënyrë të sinqertë në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2009, dhe nuk mund të konsiderohet deklarim i rremë dhe as fshehje të ardhurash. Subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërhyrë në marrëdhënien mes tyre para martesës dhe nuk mund të penalizohet në procesin e rivlerësimit.

**7.2.3.** Prindërit dhe motrat e bashkëshortes kanë pasur burime të ligjshme për dhënien e këtyre shumave, fakt që e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor për të justifikuar barrën e provës, në një kohë kur ata kanë shprehur vullnetin në deklaratat me shkrim, dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2016, duke mbajtur përgjegjësi ligjore në rast deklarimi të rremë.

7.2.4. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti me të njëjtin arsyetim si për shumën 4.440.000 lekë, pretendon se shuma 50.000 euro është kthyer në vitin 2013, fakt i deklaruar para ILDKPKI-së më datë 26.01.2016, duke e konsideruar të ezauruar si sqarim dhe deklarim përpara organit kompetent, ILDKPKI-së. Kjo shumë nuk është përdorur nga bashkëshortja si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo investimi të deklarueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting*.

7.2.5. Arsyetimi i Komisionit në vendim lidhur me mundësinë financiare të dhuruesve të shumave, është kontradiktor dhe nuk i jep mundësi subjektit të rivlerësimit për të kuptuar se si i ngarkohet një barrë prove, ku për të njëjtën gjetje, del në dy konkluzione të ndryshme.

7.2.6. Përlllogaritja e burimit të ligjshëm të të ardhurave të motrave të bashkëshortes, nuk është e saktë pasi Komisioni jo vetëm nuk ka marrë parasysh provat shkresore të ligjshme, por ka deformuar përmbajtjen e tyre në paragrafin 3.10 të vendimit nr. 395, datë 08.06.2021, pasi të ardhurat e z. I. J. për periudhën 1996 – 2006 nuk janë 62.742 euro, por 95.753 euro. Subjekti mbetet i paqartë mbi metodologjinë e përdorur nga Komisioni për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike të të afërmeve të bashkëshortes, pasi vetë zëri i shpenzimeve të jetesës me 50% të të ardhurave, nuk i korrespondon logjikës aritmetike në vlerë, të pasqyruar në analizën financiare të Komisionit.

### 7.3. Lidhur me analizën financiare për periudhën 10.12.2009 – 2016

7.3.1. Përlllogaritjet e kryera nga Komisioni jo vetëm nuk përputhen me faktet dhe provat e administruara, por shkojnë drejt pasaktësive thelbësore, si në mosmarrjen parasysh të provave, ashtu edhe në keqlllogaritjen matematikore të kryer.

7.3.2. Konkluzioni i Komisionit për të pranuar vetëm shumën 100.000 lekë nga çmimi i shitjes së automjetit “Honda Civic”, duke e konsideruar diferencën mes çmimit të shitjes dhe të blerjes prej 350.000 lekësh jashtë logjikës ekonomike, nuk qëndron. Edhe pse Komisioni merr në konsideratë vetëm vlerën 100.000 lekë, nuk e përfshin atë në vlerën e *cash*-it në analizë financiare. Argumenti i ndjekur prej tij nuk gjen mbështetje ligjore në nenin 22, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

7.3.3. Pavarësisht se nuk është deklaruar si pakësim i *cash*-it në deklaratën periodike vjetore 2012, blerja e automjetit “Volkswagen” në vlerën 700.000 lekë, nënkupton që ka dalje të mjeteve monetare ose pakësim të *cash*-it. Në këtë vit janë kryer disa transaksione të mbështetura në kontrata shitjeje dhe blerje automjeti, dhe me ndryshimin e gjendjes së likuiditetit nga arkëtimi i vlerës 450.000 lekë prej shitjes së automjetit “Honda Civic”, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive.

7.3.4. Për shkak të gabimeve në shumën vjetore të pagave, duke përlllogaritur të ardhura nga paga në vlerë më të vogël se ajo e marrë realisht sipas lëvizjeve të llogarisë në Credins Bank ShA dhe Raiffeisen Bank ShA për periudhën 2009 - 2016, duhen rishikuar të ardhurat nëpërmjet një analize të plotë të tyre, përfshirë dietat dhe urdhërshtërbimet.

7.3.5. Shpenzimet e analizuara nga Komisioni nuk qëndrojnë pasi në pjesën më të madhe, udhëtimet e subjektit dhe familjes së tij në Greqi kanë qenë te prindërit e bashkëshortes, rezidentë në qytetin e Selanikut. Shpenzimet për qëndrimin, si dhe fjetja në të gjitha rastet ka

qenë në shtëpinë e tyre, ndërkohë nga Komisioni janë llogaritur shpenzime qëndrimi në vlerën 50 euro, ku pika më e afërt është marrë Kosturi. Për qëndrimet mbi 1 (një) ditë, kostoja është përlllogaritur 5 (pesë) euro, sipas metodologjisë së Kolegjit. Komisioni ka dublikuar shpenzimet e jetesës, duke i përlllogaritur ato vjetore, pa zbritur ditët e vitit sipas shpenzimeve TIMS (kosto ushqimi, qëndrimi në Greqi).

7.3.6. Efekti financiar i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit do ta çonte bilancin negativ në vlerën (-) 158.879 lekë, e cila konsiderohet e papërfillshme dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit**

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja, vendim të cilin nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *b) Legjitimimi i ankuesit*

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 395, datë 08.06.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
11. Në fillim të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit në ankim, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin dhe debatimin në themel të fakteve dhe provave. Për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar



nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkeljeje të rëndë procedurale të Komisionit apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes.

**11.1.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se asnjë provë e administruar në Komision nuk dëshmon dhe provon se subjekti i rivlerësimit kishte pasuri të fshehura, deklarime të rreme, burime të paligjshme të pasurisë, pasuri më të madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, e që ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës për të zbatuar parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se për dy shumatat në *cash*, të deklaruara nga bashkëshortja në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, konkretisht shumatat 4.440.000 lekë dhe 50.000 euro, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, që bën të zbatueshëm nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës<sup>4</sup>. Komisioni merr vendim mbi bazën e vlerësimit të situatës faktike që paraqesin provat përgjatë shqyrtimit të çështjes dhe në rastin konkret, ka konstatuar dhe vlerësuar në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, mënyra e vlerësimit si procedurë është e mbështetur në ligj, pavarësisht se trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të shkaqeve ankimore dhe provave të administruara në dosjen gjyqësore të çështjes, mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me zbatimin e kësaj dispozite. Ashtu si arsyetuar në vijim në këtë vendim, duket që subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm dhe me dokumentacion ligjor, vërtetësinë e deklarimeve të bashkëshortes në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2009, si për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të këtyre shumave, ashtu edhe mosdeklarimit të kthimit të secilës prej tyre respektivisht, në deklaratat periodike vjetore 2013 dhe 2014. Procesi i vendimmarrjes nga institucionet e rivlerësimit është i bazueshëm vetëm në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, dhe në të drejtën që këto institucione kanë për të çmuar sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**11.2.** Zhvillimi i një hetimi sipërfaqësor, paragjykues dhe me një vendim të paracaktuar për të shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, një vlerësim i kryer jo në përputhje me nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, cenon, sipas subjektit, të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor nën dritën e standardeve të GjEDNj-së. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt nga Komisioni në këtë rast, duke mbajtur në konsideratë edhe këtë fakt, nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së.

**11.2.1.** Në analizë të këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk referon konkretisht ato elemente të procesit të rregullt ligjor që mund t'i jenë cenuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në mënyrë abstrakte, në ankim i referohet nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që përcakton standardet e kontrollit të figurës, por pa ngritur një shkak

---

<sup>4</sup> Neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

ankimor konkret që t'i nënshtrohej vlerësimit të Kolegjit. Nga analizimi i akteve të fashikullit gjyqësor administruar në Komision, trupi gjykues vlerëson se ndaj subjektit të rivlerësimit është zhvilluar një proces i rregullt ligjor dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion të gjithë kohën e nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të pyetësorëve dhe për të dhënë shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dokumentacionin mbi të cilin është bazuar vendimmarrja e Komisionit dhe për këtë ka nënshkruar deklaratën e datës 14.05.2021, për njohjen me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjes së hetimit administrativ, duke konfirmuar se nuk ka asnjë vërejtje lidhur me të, fakt i konfirmuar prej tij edhe gjatë seancës dëgjimore. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka pasur kohën e mjaftueshme për të parashtruar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të bëra në seancë nga relatorja e çështjes.

**11.2.2.** Lidhur me hetimin sipërfaqësor e paragykues përmendur në ankim, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupit gjykues nuk i rezulton asnjë qëndrim paragykues i mbajtur nga Komisioni, dhe as ndonjë pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim. Procesi i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore e rregullatore mbi bazën e të cilave Komisioni e proceson dhe e finalizon atë. Fakti që pretendimet për hetim sipërfaqësor dhe paragykues janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit, i bën këto pretendime të pabazuara.

**11.3.** Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk mori në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura prej tij në kuadër të barrës së provës, nuk dha asnjë shpjegim për vlerën e tyre provuese gjatë seancës dëgjimore dhe për çdo pretendim të subjektit të rivlerësimit në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, u mjaftua me shprehjen *se do të arsyetohej në vendimin përfundimtar*, duke u vënë në dyshim serioz për shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e të një vendimi të paragykuar dhe të paracaktuar.

**11.3.1.** Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit u referohet deklaratave të prindërve dhe motrave të bashkëshortes, të hartuara përpara fillimit të procesit të rivlerësimit, respektivisht në datat 30.01.2016 dhe 03.02.2016, si dhe aktit të ekspertimit të përgatitur nga eksperti kontabël i autorizuar. Në vendimin nr. 395, datë 08.06.2021, objekt shqyrtimi, Komisioni është shprehur se kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë raportet e institucioneve ndihmëse, dokumentet shkresore lëshuar nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim të tij, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2021, mes të cilave janë vënë në dispozicion deklarata e babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit e datës 30.01.2016, si dhe deklaratat e motrave të bashkëshortes së datës 03.02.2016, fakt të cilin Komisioni e ka pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ, paragrafi 7.4. Në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ashtu sikurse cituar më sipër, Komisioni e bazon vendimin vetëm në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera dhe çmon sipas bindjes së brendshme, mbështetur mbi to.

**11.3.2.** Lidhur me aktekspertimin e datës 24.05.2021, të ekspertës kontabël të autorizuar, znj. E. A., trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, me “Relacionin shpjegues në lidhje me rezultat e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Gentian Stoja”<sup>5</sup>, ka paraqitur këtë aktekspertim për të provuar situatën e pretenduar financiare për periudhën janar 2005 – nëntor 2009, para fillimit të detyrës si prokuror, dhe për periudhën e rivlerësimit 10 dhjetor 2009 – dhjetor 2016. Trupi gjykues sjell në vëmendje se gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, Komisioni dhe Kolegji, në zbatim të nenit 22, pika 1 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse, nëpërmjet studimit të dosjes gjyqësore për çështjen, përgatitjes së relacionit përkatës me karakter kërkimor dhe analizues. Dispozita kushtetuese (neni 179/b, pikat 2 e Kushtetutës) përcakton që procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit. Në bazë të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të këtyre normave ligjore, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron detyrat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, në respektim të legjislacionit në fuqi, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore. Në aktin e ekspertimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, citohet se për hartimin e tij, ekspertja kontabël është bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, të cilat nuk janë të ndryshme nga ato të administruara në dosjen gjyqësore e që i janë nënshtruar hetimit administrativ në Komision dhe verifikimit në Kolegj. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se akti i ekspertimit në vetvete nuk ka një vlerë provuese në procesin e vendimmarrjes, për sa kohë studimin e dosjes nga pikëpamja ligjore e financiare/ekonomike, Komisioni e kryen nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor .

**11.3.3.** Si evidentuar edhe në paragrafin 11.2.1 të këtij vendimi, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, subjekti i rivlerësimit ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të parashtruar shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të ngritura gjatë seancës dëgjimore. Provat në këtë proces janë çmuar në raport me njëra-tjetrën. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Gentian Stoja, ka ndjekur të njëjtën procedurë si edhe për subjektet e tjera të rivlerësimit, të përcaktuar nga neni 55 i ligjit nr. 84/2016, dhe akti rregullator i Komisionit “Hapat proceduralë të unifikuar”, referuar të cilëve vendimi përfundimtar merret pas bisedimeve përfundimtare me dyer të mbyllura të trupit gjykues, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, në përfundim të hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancës dëgjimore. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

**11.4.** Për pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se prej tij janë dorëzuar një sërë provash gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, por asnjëra prej tyre nuk iu nënshtrua debatit gjyqësor, duke ua lënë vendin “surprizave” në vlerësimin e tyre në vendim, e bën procesin të cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe nën dritën e KEDNj-së, se është cenuar neni 8 i kësaj konvente dhe jurisprudenca e konsoliduar e GjEDNj-së, pasi Komisioni ka hetuar çdo person, ndonëse

---

<sup>5</sup> Në vijim referuar “Shpjegime mbi rezultatet e hetimit”.

nuk kanë qenë në rrethin e personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**11.4.1.** Trupi gjykues, në përgjigje të shkaqeve ankimore të mësipërme, sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces administrativ i iniciuar kryesisht. Referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë, vlerësojnë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke kërkuar dhe administruar dokumentet për realizimin e hetimit administrativ. Vendimmarrja e Komisionit bazohet në këto dokumente dhe në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorëve dhe me shpjegimet për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, në kuadër të barrës së provës sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha aktet shkresore administrohen në dosjen gjyqësore dhe trajtohen në harmoni me provat e tjera. Po kështu, nuk rezulton që Komisioni të ketë përfshirë në vendim elemente të cilat nuk i ka trajtuar gjatë hetimit administrativ dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegimet e tij.

**11.4.2.** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka hetuar mundësinë e krijimit nga burime të ligjshme të dy shumave të konsiderueshme të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2009, në vlerat 4.440.000 lekë dhe 50.000 euro, të drejtë që ia njeh neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitat e ligjit nr. 84/2016, që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë dhe nivelit të besueshmërisë së këtij kriteri. Në këto kushte, trupi gjykues nuk konstaton që Komisioni të ketë ndërhyrë në jetën private dhe familjare të subjektit të rivlerësimit, sa të ketë cenuar të drejtën e tij të parashikuar në nenin 8 të KEDNj<sup>6</sup>-së apo jurisprudencën e konsoliduar të GjEDNj-së. Në këtë vendim, trupi gjykues ka dhënë vlerësimin e tij lidhur me shumat e sipërcituara. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

12. Në përfundim të analizimit të shkaqeve me natyrë procedurale, duke mos konstatuar raste apo rrethana që të plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ankimi i subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja kundër vendimit 395, datë 08.06.2021, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë**

*Për kursimet cash në vlerën 4.440.000 lekë*

13. Për këto kursime, Komisioni ka arritur në përfundimet se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten deklarative e të paprovuara në ndonjë formë ligjore apo nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore. Po ashtu, e paprovuar mbetet dhe mundësia për krijimin e shumës 4.440.000

---

<sup>6</sup> Neni 8 i KEDNj-së parashikon: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

lekë me burim nga qiradhënia e një pasurie, e cila vlerësohet modeste, e ndodhur në qytet dhe jo në zonë bregdetare, pa konsumim të energjisë elektrike apo ujësjellësit dhe pa dokument provues se marrëdhënia e qiradhënies ka ekzistuar. Edhe nëse merret në konsideratë një qiradhënie sezonale, sipas pretendimeve të subjektit, përsëri vlera prej 4.440.000 lekësh, referuar dokumentacionit të administruar dhe provave e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, konsiderohet e lartë dhe e pamundur për t'u krijuar. Personi i lidhur, bashkëshortja, ka bërë deklaram të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës 2009, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaramet periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e gremës “c” të pikës 5 të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dhëna lidhur me këtë pasuri.

14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet Komisionit në ankim, duke i konsideruar ato të pabazuara e alogjike dhe duke ngritur pretendimet se: (i) kjo shumë nuk buron nga të ardhurat gjatë martesës dhe aq më pak gjatë ushtrimit nga subjekti i rivlerësimit të detyrës si prokuror, por u përket prindërve të bashkëshortes dhe nuk i është dhuruar kësaj të fundit, por i është lënë në ruajtje. Mosndërhyrja në këtë marrëdhënie nuk mund ta penalizojë subjektin në procesin e rivlerësimit; (ii) mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i kësaj shume, vjen pasi shuma është kthyer nga bashkëshortja te prindërit e saj në vitin 2014, fakt i deklaruar përpara organit kompetent, ILDKPKI-së, më 26.01.2016. Shuma nuk ka shërbyer si burim krijimi për ndonjë pasuri apo investim të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, dhe prej kësaj shume nuk janë gjeneruar apo përfituar interesa apo të ardhura të tjera. Në këto kushte, nuk është konsideruar si detyrim për ta deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*; (iii) Komisioni nuk dha asnjë shpjegim se përse provat, argumentet ligjore dhe financiare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk qëndronin. Konstatimi se shpjegimet e subjektit mbeten deklarative dhe të paprovuara në ndonjë formë ligjore apo nëpërmjet deklarameve periodike vjetore, është i padrejtë. Komisioni nuk arriti të analizojë drejt faktet dhe rrethanat, të cilat në asnjë rast nuk kanë qenë kontradiktore, të paqarta apo jokoherente me deklaramet e subjektit të rivlerësimit përgjatë viteve, si dhe në dokumentin e vlerësimit. Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti janë më se të mjaftueshme për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës; (iv) i pavend, kontradiktor dhe jokoherent është qëndrimi i Komisionit, lidhur me shumën 4.440.000 lekë që kanë si burim të ardhurat nga qiratë, duke i konsideruar si të pabesueshme, të mbetura në kontekstin deklarativ.
15. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se situata faktike lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë shumë objekt kontrolli, paraqitet si vijon.

15.1. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. K., deklaroi: *Nga prindërit e mi disponoj kursime nga të ardhurat nga qiraja e një apartamenti banimi në rr. “{\*\*\*}”, në Durrës, lëshuar me qira që në vitin 1992, në cash, jo depozita. Në shumën 4.440.000 lekë.*

15.2. Për këto kursime, si dhe për shumën e dhuruar prej 50.000 eurosh, ILDKPKI-ja, në raportin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë *vetting* për subjektin e rivlerësimit Gentian Stoja, konstaton mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumave

të dhuruara nga prindërit dhe motrat e bashkëshortes. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2009 – 2016, përdorimin apo destinacionin e gjendjes *cash* prej 65.000 eurosh dhe 4.440.000 lekësh, gjendje e cila në deklaratën e pasurisë *vetting*, është 1.100.000 lekë.

**15.3.** Sa i përket origjinës së këtyre kursimeve prej 4.440.000 lekësh, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se është pasuri ekskluzive e prindërve të bashkëshortes, e krijuar para vitit 2007, përpara se subjekti të njihej me bashkëshorten e të lidhte martesë me të në korrik 2007, apo të emërohej prokuror me dekretin e Presidentit të Republikës në dhjetor 2009. Ai shprehet se nuk ka treguar asnjëherë interes për shumën 4.440.000 lekë, pasi nuk ka qenë në asnjë rast pasuri e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij. Arkëtimi ndër vite i kësaj shume sipas subjektit, bëhej nga pronarët e ligjshëm të këtij apartamenti, prindërit e bashkëshortes, me ardhjet e herëpashershme të tyre në Durrës. Sipas informacionit të dhënë nga bashkëshortja, në raste të rralla të pamundësisë për të ardhur në Shqipëri, të ardhurat nga qiraja janë arkëtuar nga gjyshja e bashkëshortes, znj. E. F., e cila ka ndërruar jetë në vitin 2010. Këto të ardhura kanë variuar nga 250.000 lekë deri në 350.000 lekë në vit dhe shuma e mbledhur deri para martesës, nuk është kaluar jashtë shtetit, por ka qenë ruajtur në banesën e gjyshes në Durrës. Pasi bashkëshortja u kthye nga Greqia për të jetuar në Korçë në vitin 2007, për arsye sigurie dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të gjyshes, shumën e kanë marrë në banesën e tyre në Korçë. Kjo shumë, sipas subjektit, nuk i është dhuruar bashkëshortes, por në kuadër të një marrëdhënieje prind-fëmijë, i është lënë në ruajtje dhe i është dhënë e drejta që në raste të nevojshme të shpenzonte pjesë të arsyeshme të saj, prej të cilave janë shpenzuar rreth 1.000.000 lekë ndër vite<sup>7</sup>, pas martesës (në periudhën 2010 – 2014), për shpenzime personale të bashkëshortes dhe udhëtimet që ajo ka kryer në Greqi për të takuar prindërit.

**15.4.** Lidhur me mosdeklarimin e shumës në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shuma është kthyer në vitin 2014, fakt që e ka deklaruar dhe përpara ILDKPKI-së më datë 26.01.2016, duke e konsideruar të ezauruar si sqarim dhe deklaram përpara organit kompetent. Duke qenë se shuma është kthyer në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk e ka konsideruar si detyrim për ta deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi kjo shumë nuk ka shërbyer si burim krijimi për ndonjë pasuri apo investim për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten, dhe nuk ka gjeneruar interesa prej saj. Marrëdhënia e posaçme prind-vajzë është deklaruar në mënyrë të sinqertë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, të cilat, sipas subjektit, nuk janë deklarime të rreme dhe as fshehje të ardhurash. Deklarimi i tyre në vitin 2009 është bërë për faktin se subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së. Për sa kohë prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi financiare për t'ia lënë në disponim dhe përdorim këtë shumë, përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor për të justifikuar barrën e

---

<sup>7</sup> Në përgjigjet e datës 06.05.2021, lidhur me shumën e shpenzuar prej 1.000.000 lekë, subjekti sqaron se sipas përlllogaritjeve të tij të përafërta shuma është shpenzuar: -- në vitin 2010, është shpenzuar 154.500 lekë, -- në vitin 2011, shuma 227.700 lekë, -- në vitin 2012 shuma 218.088 lekë, -- në vitin 2013 shuma 213.562 lekë, -- në vitin 2014 shuma 195.150 lekë.

provës, në një kohë që kanë shprehur vullnetin e tyre në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI në vitin 2016, duke mbajtur edhe përgjegjësi ligjore për deklaram të rremë.

**15.5.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se në kuadër të hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2021, përcjell procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 26.01.2016, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se prindërit e bashkëshortes janë emigrantë nga viti 1992, në Selanik, Greqi. Meqë prindërit dhe motrat e bashkëshortes jetojnë jashtë vendit, për këtë apartament përkujdeset bashkëshortja. Qiraja, sipas subjektit, është përfituar gjatë sezonit të plazhit dhe për të nuk është hartuar kontratë qiraje. Gjendja në lekë e deklaruar nga bashkëshortja, 4.440.000 lekë, ka pësuar pakësime gjatë viteve për shkak të udhëtimeve të saj te prindërit në Greqi, si dhe shpenzimeve të tjera personale të saj, por pa e kaluar limitin e shpenzimeve të deklarueshme. Në fund të vitit 2014, gjendja *cash* e kësaj shume ka qenë rreth 3.400.000 lekë, shumë e cila u është kthyer prindërve të bashkëshortes kur është kërkuar nga ana e tyre atë vit.

**15.6.** Për të provuar deklaramet e dhëna para ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka depozituar certifikatën e pronësisë së apartamentit me sipërfaqe 84,33 m<sup>2</sup> në Durrës, në emër të prindërve të bashkëshortes dhe një deklaratë të z. V. K. (vjeherri i subjektit), të datës 30.01.2016, në të cilën deklaron se apartamentin që ka në pronësi në qytetin e Durrësit, të përfituar nëpërmjet privatizimit, e ka lëshuar me qira që prej vitit 1992, kryesisht gjatë sezonit turistik. Pas largimit në emigrim, të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e kësaj pasurie, në shumën 4.400.000 lekë, ia ka lënë në administrim vajzës M. K. para martesës së saj me z. Gentian Stoja, për arsye që ajo t’i vizitonte shpesh në Greqi, por edhe për të mbuluar nevojat e ngutshme ekonomike që mund të kishte, brenda një kufiri të arsyeshëm monetar. Për vetë natyrën e lëshimit me qira për periudha të shkurtra qëndrimi, të cilat variojnë nga 10 deri 20 ditë, nuk dispononte fatura apo dokumente të qirave sezonale. Vjeherri i subjektit gjithashtu deklaron se ka marrë shumën 3.400.000 lekë (shuma e mbetur nga 4.400.000 lekë) gjatë viteve 2014 – 2015, të cilat i ka çuar në Greqi herë pas here, së bashku me bashkëshorten, pa kaluar kufirin e detyrueshëm për t’u deklaruar në doganë.

**15.7.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të datës 02.03.2020, subjekti i rivlerësimit sqaron se në fund të vitit 2014, ka mbetur shuma 3.400.000 lekë, e cila e konvertuar në euro, i është kthyer prindërve të bashkëshortes. Lidhur me dokumentacionin justifikues ligjor të kërkuar nga Komisioni për këmbimin në euro të shumës 3.400.000 lekë, si dhe faktin e deklaramit të kësaj shume në doganë, me përgjigjet e pyetësorit të datës 16.04.2021, subjekti i rivlerësimit sqaron se bashkëshortja dhe nëna e saj kanë shkuar në një zyrë këmbimi, por nuk kanë marrë ndonjë dokument apo faturë për këmbimin e kryer. Sipas të thënave të prindërve të bashkëshortes, të cilët i kanë vizituar shpesh herë, shumat në kufi i kanë kaluar vetë ata, jo të gjithë shumën monetare prej 3.400.000 lekësh njëherësh, si për arsye sigurie, ashtu edhe për të respektuar rregullat e kalimit në kufi, duke mos kaluar limitin e detyrueshëm për t’u deklaruar.

**15.8.** Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka reflektuar në vendim dy aktet shkresore, konkretisht përgjigjet e OSHEE-së dhe UKD-së, duke mos dhënë asnjë shpjegim se përse provat, argumentet ligjore dhe financiare të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk qëndronin, trupi gjykues konstaton

se Komisioni, në kuadër të hetimit, u ka kërkuar informacion shoqërive Ujësjetës Kanalizime Durrës ShA (në vijim “UKD ShA”) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group ShA (në vijim “OShEE ShA”), lidhur me individin V. K..

**15.8.1.** UKD ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.04.2021, informon se në emër të z. V. K., rezulton një kontratë furnizimi (kontrata nr. {\*\*\*}, debitore në vlerën 8.000 lekë të reja). Referuar të dhënave të përcjella me këtë shkresë për periudhën 29.02.2008 deri 31.07.2010, është faturuar në zero lekë, ndërsa nga data 30.11.2010 deri më 30.12.2015, është faturuar me 120 lekë, përveç dy muajve të verës në vitin 2010 dhe vitin 2015, kur është faturuar më tepër. Ndërsa më pas, sipas konsumit, faturuar në vlera të ndryshme.

**15.8.2.** OShEE ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2021, informon se z. V. K. dhe znj. R. K., referuar sistemit të faturimit, nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA, pjesë e Grupit OShEE ShA. Në këtë shkresë sqarohet se këto të dhëna të merren me rezervë, pasi për shkak të mungesës së pasqyrimin të të dhënave më të detajuara, nuk sigurojnë saktësinë e plotë të tyre.

**15.9.** Në shpjegimet për konstatimin e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ se nuk rezulton ndonjë provë që prindërit e bashkëshortes së subjektit të kenë përfituar të ardhurat nga qira apo të kenë paguar tatime në lidhje me to, subjekti i rivlerësimit depoziton shkresat “kthim përgjigje” nga OShEE ShA dhe UKD ShA.

**15.9.1.** Në shkresën e OShEE ShA nr. {\*\*\*} prot., datë 18.05.2021, citohet se sipas kërkimit në sistemin e menaxhimit të kontratave, me emrin V. K., rezulton një kontratë furnizimi me energji elektrike familjare për apartament banimi, me status *aktiv*, pasi konsumohet sasi energji elektrike dhe faturohet. Sipas së njëjtës shkresë, kontrata është lidhur më datë 20.05.1998. Matësi i kontratës është vendosur në të njëjtën datë me atë të lidhjes së kontratës, ndërsa më datë 23.09.2015, është bërë vulosje dhe sistemim matësi. Abonenti V. K. është furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me energji elektrike dhe nuk rezulton debitor ndaj OShEE ShA.

**15.9.2.** Në shkresën e UKD ShA nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2021, citohet se në sistemin e faturimit, figuron një kontratë në emër të konsumatorit V. K., me nr. {\*\*\*}, me adresë lagjia nr. {\*\*\*}, rr. “{\*\*\*}”, ndërtesa {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, ap. nr. {\*\*\*}, me të dhënat e mjetit të identifikimit nr. {\*\*\*}, me status *aktiv*. Sipas kësaj shkrese, kontrata është e vjetër, e mbartur në sistemin elektronik të UKD ShA, por figuron në sistemin e faturimit nga data 27.07.2006. Matësi për këtë kontratë, figuron i vendosur dhe vulosur më datë 08.09.2014, dhe nuk është debitor.

**15.10.** Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe atij të administruar nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ, nuk provohet dhënia me qira e apartamentit në Durrës, si dhe përfitimi i të ardhurave nga kjo marrëdhënie qiraje. Përgjigjet me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2021 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 18.05.2021, të shoqërive aksionere UKD dhe OShEE respektivisht, nuk provojnë që apartamenti është përdorur nga prindërit e bashkëshortes, nuk provojnë konsum uji dhe energjie të regjistruar për periudhën 1992 – korrik 2007 e, për rrjedhojë, nuk provohet që ky apartament ka gjeneruar të ardhura gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht se kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike mund të jenë aktive, këto shkresa nuk japin informacion për periudhën 1992 – korrik 2007 gjatë së cilës



pretendohet të jenë përfituar këto të ardhura. Me konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se marrëdhënia e qirasë asnjëherë nuk ka qenë për periudha mbi 1- (një) vjeçare, madje as 6- (gjashtë) mujore, çka do ta detyronte pronarin e apartamentit të lidhte kontratë me shkrim, bazuar në nenin 803, paragrafi 4 i Kodit Civil, mbetet e paqartë për trupin gjykues se përse kjo shumë e konsiderueshme, prej 4.440.000 lekësh, nuk është depozituar në llogari bankare, por është mbajtur *cash* në banesë. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk bazohen në asnjë dokument të kohës për përfitimin e ndonjë të ardhure nga qiraja dhe, me të drejtë, Komisioni i ka vlerësuar deklarative, shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje.

**15.11.** Në përfundim, në kushtet kur nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor burimi i ligjshëm i krijimit të shumës *cash* 4.440.000 lekë, të disponuar nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2009, nuk u shpjegua bindshëm mbajtja e kësaj shume të konsiderueshme në banesën e subjektit të rivlerësimit, pasi ai nuk ka depozituar qoftë edhe një dokument për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë për apartamentin në emër të prindërve të bashkëshortes në Durrës për periudhën 1992 – korrik 2007, nuk u deklarua më pas kthimi i shumës së mbetur, prej 3.400.000 lekësh, në deklaratën periodike vjetore 2014, trupi gjykues vlerëson se gjithë sa më sipër afekton vërtetësinë e deklaramit para fillimit të detyrës në vitin 2009, si dhe provon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sinqertë në qëndrimin e mbajtur në Komision, lidhur me zotërimin e administrimin e kësaj shume. Këtë rrethanë, trupi gjykues e mban në konsideratë në vlerësimin e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në vlerësimin në tërësi të kriterit të pasurisë dhe sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve.

*Lidhur me të ardhurat cash në formë dhurate në vlerën 50.000 euro*

- 16.** Komisioni, lidhur me këtë vlerë, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar burimin e ligjshëm të dhuruesve dhe mundësitë e tyre financiare për dhurimin e shumës prej 50.000 eurosh. Pretendimet e subjektit se këto shuma të dhuruara janë kthyer, mbeten deklarative dhe të paprovuara. Argumentet e pretenduara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, se nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie dhe fakti se kthimi i tyre nuk gjen pasqyrim në asnjë prej deklaramive periodike vjetore, i bën deklaramet e personit të lidhur të rreme dhe se subjekti i rivlerësimit ka fshehur të dhëna lidhur me këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*. Jo vetëm që nuk ka asnjë dokument ligjor provues mbi kthimin e këtyre shumave, por dhe arsyetimi se nuk do të blinin shtëpi, nuk duket bindës, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë një pasuri (truall + shtëpi) në vitin 2019, ku në vijim kanë ndërtuar një shtëpie banimi private (vilë). Mbetet e paprovuar mundësia për krijimin e gjithë shumës 50.000 euro, në plotësim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mbetet deklarativ posedimi i kësaj vlere nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, si dhe mbetet i paprovuar kthimi i këtyre shumave te dhuruesit. Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti, dhe ky i fundit nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaramet periodike vjetore, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e gurmës “c” të pikës 5 të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dhëna lidhur me këtë pasuri.

17. Kundër këtyre konkluzioneve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimet se: (i) Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet e tij, ku ka sqaruar qartë burimin e shumave të dhuruara dhe ka depozituar dokumentacion ligjor nga autoritetet e huaja, greke dhe italiane, në lidhje me burimin e krijimit të tyre për periudhën kur janë dhuruar; (ii) arsyetimi i Komisionit në vendim, lidhur me mundësinë financiare të dhuruesve të shumave, është kontradiktor dhe nuk i jep mundësi subjektit të rivlerësimit për të kuptuar se si i ngarkohet një barrë prove, ku për të njëjtën gjetje, dalin në dy konkluzione të ndryshme; (iii) përllogaritja e të ardhurave të z. I. J. është e gabuar. Subjekti mbetet i paqartë mbi metodologjinë e përdorur nga Komisioni për përllogaritjen e shpenzimeve jetike të të afërmeve të bashkëshortes, pasi vetë zëri i shpenzimeve të jetesës, me 50% të të ardhurave, nuk i korrespondon logjikës aritmetike në vlerë, të pasqyruar në analizën financiare të Komisionit; (iv) shuma 50.000 euro është kthyer në vitin 2013, fakt i deklaruar para ILDKPKI-së më datë 26.01.2016, duke e konsideruar të ezauruar si deklaram. Kjo shumë nuk është përdorur nga bashkëshortja si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo investimi të deklarueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting*.

18. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton situata faktike si vijon.

18.1. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. K., deklaron: *Nga prindërit dhe motrat kam përfiturar të ardhura në formë dhurate me rastin e martesës, në cash, jo depozita. Në shumën 50.000 euro.*

18.2. Lidhur me këtë shumë, në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 26.01.2016, përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2021, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është martuar në vitin 2007 dhe duke qenë se martesa ndodhi shpejt, prindërit dhe dy motrat e saj i dhuruan shumën 50.000 euro në formë paje, me qëllim blerjen e një apartamenti. Për burimin e kësaj shume, subjekti ka sqaruar se prindërit e bashkëshortes kanë kryer punë të ndryshme, në fabrikë për prodhimin e pajisjeve për industrinë e mishit, fabrikë tezgjahu, si dhe firmë për termo-hidro-izolime, ndërsa motrat kanë punuar si kujdestare për të moshuar, në marrëdhënie pune kanë qenë dhe bashkëshortët e tyre. Gjendjen *cash* në shumën 50.000 euro, subjekti i rivlerësimit deklaron se nuk e disponon pasi u është kthyer prindërve të bashkëshortes, për arsye se apartamenti nuk u ble. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në ILDKPKI, deklarata të vjehrrit dhe motrave të bashkëshortes, si vijojnë.

18.2.1. Deklaratë jonoteriale, datë 30.01.2016, e z. V. K., i cili deklaron se, së bashku me bashkëshorten, kanë emigruar në Greqi prej vitit 1992, e banon në Selanik ku kanë kryer punë të ndryshme, në firma, fabrika, por edhe privatisht, ndërsa vajzat e tij po prej atij viti kanë emigruar në Itali. Martesa e së bijës, sipas z. K., ka ndodhur shpejt pasi ajo priste një fëmijë, dhe së bashku me dy vajzat e tjera kanë vendosur për t'i dhënë në formë paje shumën 50.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti në Korçë; ai i ka dhuruar 18.000 euro, ndërsa motrat nga 16.000 euro secila. Në kushtet kur vajza dhe bashkëshorti janë kthyer te banesa e prindërve të tij, dhuruar këtij të fundit, ata kishin hequr dorë nga blerja e apartamentit, dhe vajza nuk e ka konsideruar të drejtë mbajtjen e kësaj shume, e cila nuk i shërbente më qëllimit për të cilin ishte dhuruar, dhe pasi ka biseduar edhe me vajzat e tjera, kanë rënë dakord që kjo shumë të mbahej nga prindërit dhe të përdorej për nevojat e tyre, pasi ato nuk kishin nevoja të ngutshme

familjare. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjithashtu në ILDKPKI edhe deklarata tatimore mbi të ardhurat e viteve financiare 2002, 2005, 2006, 2007 të prindërve të bashkëshortes, V. dhe R. K..

**18.2.2.** Deklaratë jonoteriale e znj. E. K., e datës 03.02.2016, e nënshkruar dhe nga bashkëshorti, z. D. K., ku ajo deklaron se së bashku me bashkëshortin kanë emigruar në Itali që prej vitit 1993, dhe janë shtetas italianë, që bëjnë punë të ndryshme e kanë përfituar të ardhura të konsiderueshme. Për arsye se i kishin kushtet dhe mundësitë financiare, së bashku me prindërit kanë vendosur t'i dhurojnë motrës një shumë të caktuar parash në formën e pajës, që do t'i duhej për të blerë një apartament ose t'i shpenzonin meqenëse do të krijonin një familje të re. Znj. E. K. deklaron se i ka dhuruar së motrës 16.000 euro, pa akt të shkruar për shkak të marrëdhënies së tyre, dhe ka vënë në dispozicion deklarata të të ardhurave vjetore (CUD<sup>8</sup>) të bashkëshortit të saj, z. D. K.. Po kështu dhe motra tjetër e bashkëshortes, znj. E. K., së bashku me bashkëshortin e saj, z. I. J., kanë lëshuar deklarata të thjeshtë jonoteriale, me të njëjtat deklarime, duke paraqitur deklarata të të ardhurave vjetore (CUD) 2002 - 2005 të bashkëshortit I. J., si dhe vërtetim për të ardhurat e vitit 2007.

**18.3.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin qëndrim me babain e bashkëshortes në deklaratën e bërë prej tij më datë 30.01.2016, duke sqaruar se, në kushtet kur në vitin 2011, prindërit i dhuruan apartamentin në pronësi të tyre dhe subjekti dhe familja e tij u kthyen të jetonin së bashku me prindërit e subjektit, menduan që shumën e dhënë për një destinacion të caktuar të mos e shpenzonin dhe ia kaluan pa të drejtë kthimi prindërve të bashkëshortes në Greqi, të cilët e kanë shpenzuar për nevojat e tyre. Vendimmarrjen për këtë çështje e kanë pasur bashkëshortja dhe motrat e saj, duke qenë se i përkiste familjes së saj përpara martesës, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërhyrë në këtë marrëdhënie. Për të provuar mundësinë financiare të prindërve dhe motrave të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumente mbi ta ardhurat e tyre, të tilla si: (i) Deklaratë e Llogarisë së Sigurimeve Shoqërore (*Estratto Conto Previdenziale*), lëshuar më datë 17.01.2020, për z. I. J., të dhëna për të ardhurat e tij nga viti 1996 deri në dhjetor 2019; (ii) Deklaratë e Llogarisë së Sigurimeve Shoqërore (*Estratto Conto Previdenziale*), lëshuar më datë 13.01.2020 për z. D. K., të dhëna për të ardhurat e tij nga viti 2002 deri në nëntor 2019; (iii) Deklaratë e Llogarisë së Sigurimeve Shoqërore (*Estratto Conto Previdenziale*), lëshuar më datë 13.01.2020 për znj. E. K., të dhëna për të ardhurat e saj nga viti 2009 deri në nëntor 2019; (iv) “Akt rakordimi mbi të ardhurat e personave fizikë” për periudhën 1999 –2003 dhe “Akt rakordimi i tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë mbi bazën e deklaratës fillestare” për periudhën 2004 – 2018 për z. V. K. dhe znj. R. K., që përmbajnë të dhëna mbi shumën totale të të ardhurave të deklaruara për secilin vit.

**18.4.** Në kushtet kur shuma 50.000 euro ka qenë një dhuratë e prindërve dhe motrave të bashkëshortes, deklaruar në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2009, e cila nuk gjen pasqyrim në deklaratën e vitit 2013, kur pretendohet të jetë kthyer, dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni ka kryer analizën financiare të prindërve të bashkëshortes për dhurimin e shumës 18.000 euro, si dhe të motrave të saj për dhurimin e

---

<sup>8</sup> CUD – akronim për “*Certificazione Unica dei redditi di lavoro Dipendente*” (“Vërtetim i të ardhurave personale nga puna e punëmarrësit”).

shumës 32.000 euro (nga 16.000 secila). Në analizën financiare për të verifikuar mundësinë e prindërve të bashkëshortes për të dhuruar shumën 18.000 euro, duket që Komisioni, përveç shpenzimeve të jetesës, nuk ka përfshirë shpenzime të tjera, si qiraje, udhëtimi apo për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}, i cili nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultojnë të jetë përdorur prej prindërve të bashkëshortes. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi financiare për dhënien e shumës 18.000 euro. Ndërsa motrat e bashkëshortes, sipas Komisionit, rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhurimin e shumës 32.000 euro (të dyja). Analiza financiare e kryer në Komision përfshin periudhën për të cilën është depozituar dokumentacion i justifikues ligjor për të ardhurat e tyre, nga viti 1996, pavarësisht se, sipas subjektit të rivlerësimit, analiza duhej të shtrihej nga viti 1992<sup>9</sup>. Në kushtet kur subjekti, në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të barrës së provës, nuk ka depozituar dokumente lidhur me të ardhurat e realizuara prej tyre nga viti 1992, kjo e bën të pamundur kryerjen e analizës financiare sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit.

**18.5.** Në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të motrave të bashkëshortes për dhënien e shumës 32.000 euro (16.000 euro secila), Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, në drejtim të analizimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me llogaritjen e gabuar të të ardhurave neto të z. I. J., si dhe mënyrën e përcaktimit të shpenzimeve të jetesës për familjet e motrave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për periudhën e analizuar, 1996 - 2006. Ndryshe nga Komisioni që ka llogaritur të ardhurat e z. I. J. për periudhën 1996 – 2006, në vlerën 62.742 euro, Kolegji, për përcaktimin e këtyre të ardhurave, iu referua dokumentit “Deklaratë e llogarisë së sigurimeve shoqërore” (*Estratto Conto Previdenziale*), lëshuar më datë 17.01.2020, nga INPS-ja, sipas të cilit rezultojnë në vlerën 94.365 euro. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1999 – 2006, janë përlllogaritur për dy familje me dy anëtarë (katër në total), dy motrat dhe bashkëshortët përkatës, pa përfshirë fëmijët pasi nuk ka të dhëna për përbërjen familjare të tyre, dhe ndryshe nga Komisioni që u është referuar të dhënave të Eurostat për Italinë<sup>10</sup>, Kolegji, për të qenë sa më garantist ndaj subjektit të rivlerësimit, iu referua të dhënave të Institutit Kombëtar të Statistikave Itali, në nivel varfërie<sup>11</sup>. Për vitet kur shpenzimet sipas kësaj përlllogaritjeje rezultojnë më të larta se të ardhurat, shpenzimet janë përlllogaritur në nivelin e të ardhurave, me efekt zero për atë vit. Analiza e Komisionit, e korrigjuar në elementet e mësipërme, për të cilat disponohen të dhëna në Kolegji apo nga burime të hapura dhe të aksesueshme, për periudhën 1996 – 2006, tregoi që motrat e bashkëshortes kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 51.094 euro, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhurimin e shumës 32.000 euro, nëse të ardhurat e ekstraktuara nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore konsiderohen bruto, dhe në vlerën (-) 25.699 euro, nëse këto të ardhura përlllogariten neto, pas tatimeve.

**18.6.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni në vendim është kontradiktor pasi del në dy konkluzione të ndryshme lidhur me mundësinë financiare të dhuruesve të shumave,

---

<sup>9</sup> Nga dokumenti i identifikimit, rezultojnë se znj. E. K. (motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), në vitin kur deklaroi se ka emigruar në Itali, ka qenë vetëm 13 vjeçe, pasi rezultoi e datëlindjes 20.02.1980.

<sup>10</sup> <https://eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>.

<sup>11</sup> <http://dati.istat.it/Index.aspx?QueryId=17446>.

trupi gjykues e gjen të pabazuar. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në paragrafin 3.8 të vendimit është shprehur që prindërit e bashkëshortes në vitin 2007 kanë mundësi financiare për dhurim të shumës 18.000 euro vajzës së tyre, ndërsa në paragrafin 3.10, se motrat e bashkëshortes së subjektit kanë qenë në pamundësi financiare për të bërë dhuratë në vlerën 32.000 euro, për rrjedhojë, me të drejtë Komisioni në paragrafin 3.13 të vendimit konkludon se *subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të dhuruesve dhe mundësitë e tyre financiare për të dhuruar shumën e plotë prej 50.000 eurosh*. Me fjalë të tjera, në kushtet kur një nga dhuruesit ndodhet në pamundësi financiare dhurimi, në këtë rast motrat e bashkëshortes, atëherë pamjaftueshmëria e tyre afekton burimin e ligjshëm të shumës së plotë të dhuruar.

**18.7.** Lidhur me mosdeklarimin e shumës 50.000 euro në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo shumë është kthyer në vitin 2013, fakt të cilin e ka deklaruar para ILDKPKI-së më datë 26.01.2016, duke e konsideruar të ezauruar si deklarim. Kjo shumë, sipas tij, nuk është përdorur nga bashkëshortja si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo investimi të deklarueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting*. Trupi gjykues i Kolegjit, përveç pamjaftueshmërisë së konstatuar për dhënien e shumës 50.000 euro në formë dhurate, në linjë me Komisionin, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten deklarative dhe të paprovuara, ku përveç mosdeklarimit në deklaratën periodike vjetore 2013, kthimi i shumës nuk provohet me asnjë dokument tjetër ligjor. Janë një sërë rrethanash, të cilat bëjnë jo vetëm deklarative shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, por edhe të pabesueshme, pasi kthimi i pretenduar i shumës në vitin 2013, nuk lidhet me ndonjë veprim tjetër të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes, me fjalë të tjera mbetet i pashpjegueshëm fakti se përse shuma 50.000 euro nuk u kthye në vitin 2011, kur subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja vendosën të jetonin në shtëpinë e dhuruar<sup>12</sup> nga prindërit dhe motra e subjektit të rivlerësimit. Kthimi i shumës është në fakt pakësim i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes dhe, si i tillë, do të duhej të deklarohet.

**18.8.** Nga ana tjetër, ashtu siç është konstatuar dhe nga Komisioni në vendim, duket që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kishin hequr dorë nga ideja për të blerë një shtëpi të re, pasi ashtu siç rezulton nga aktet në dosjen gjyqësore<sup>13</sup>, nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme, me kusht kreditimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2019, subjekti dhe bashkëshortja kanë blerë truallin me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe ndërtesën me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Korçë. Si burim ka shërbyer kredia e përfituar nëpërmjet kontratës së kredisë bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.07.2019, nënshkruar mes tij dhe bashkëshortes në cilësinë e kredimarrësit dhe Bankës së Parë të Investimeve – Albania ShA, në vlerën 8.000.000 lekë, për blerje pasurie të paluajtshme dhe rikonstruksion shtëpie.

---

<sup>12</sup> Kontratë dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2011, nënshkruar mes palës dhuruese, S. S., E. S. dhe I. D. (S.), dhe palës pranuese të dhurimit, Gentian Stoja, me objekt apartamentin e banimit, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, me sipërfaqe 89,76 m<sup>2</sup>.

<sup>13</sup> Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.02.2020, pas verifikimit të dokumentacionit që disponon, informon se Gentian Stoja figuron pronar i pasurisë apartament<sup>13</sup> me sipërfaqe 89,76 m<sup>2</sup>, si dhe bashkëpronar me bashkëshorten në “truall me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, nga të cilat 71 m<sup>2</sup> ndërtesë”.

**18.9.** Mbështetur në rrethanat faktike parashtruar më sipër, trupi gjykues, në funksion të vlerësimit të tij mbi çështjen, mban në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, të sjellë në vëmendje dhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrimet e depozituara në Kolegj më datë 14.07.2023, nr. {\*\*\*} prot., si lidhur me objektin e hetimit dhe vlerësimit nga institucionet e rivlerësimit në kuadër të kriterit të pasurisë, ashtu edhe me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji për pasuri të krijuara jashtë regjimit martesor. Më konkretisht, në kuptim të dispozitave kushtetuese, nenit Ç, pika 1, nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës<sup>14</sup> së Kolegjit, objekti i hetimit dhe vlerësimit të pasurisë materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, krahasuar me deklaratimet periodike, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe personave të lidhur. Kolegji ka mbajtur qëndrim se pamjaftueshmëria e deklaratimit në deklaratat periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaram të rremë, në vitet përkatëse nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaratimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin nga detyra e subjektit. Nga ana tjetër, në drejtim të pasurisë së krijuar jashtë regjimit martesor, Kolegji në jurisprudencën<sup>15</sup> e tij, ka mbajtur këtë qëndrim: *[...] problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Ndërsa problematikat që lidhen me pasuritë e vëna prej tij apo defektet në deklaramin e saj, të cilat përsëri konsistojnë në një situatë të mbartur nga pasuritë e personit të lidhur, të krijuara para martesë, gjithashtu nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri.* Çështje të tilla, sipas qëndrimit të Kolegjit, vlerësohen në këndvështrim të afektimit të nivelit të besueshmërisë për kriterin e pasurisë dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ato do të vlerësohen prej Kolegjit në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit.

**18.10.** Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se për pasuritë e deklaruar nga bashkëshortja në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009: (i) shuma në *cash* prej 4.440.000 lekësh, kursime me burim të ardhurat nga qiratë; (ii) dhuratë *cash* në shumën 50.000 euro nga prindërit dhe motrat, subjekti i rivlerësimit është i pavërtetë në deklaramin e gjendjes së interesave të tij private në vitin 2009, për sa kohë nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, nuk provon kthimin e këtyre shumave në vitet 2013 dhe 2014, dhe është treguar i pasinqertë në qëndrimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me zotërimin dhe administrimin e tyre. Në ndryshim nga Komisioni, i cili ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për fshehje të këtyre shumave në deklaratën e pasurisë *vetting* e, për pasojë, ka zbatuar nenin 61, pika 3 e këtij ligji, trupi gjykues i Kolegjit, në pamundësi për të mbajtur një qëndrim përfundimtar për situatën faktike rreth këtyre shumave, për pasojë dhe për

---

<sup>14</sup> Shih vendimet (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 12, datë 17.12.2018, paragrafi 24.11; nr. 6, datë 28.02.2019, paragrafi 20.4; nr. 13, datë 20.06.2019, paragrafi 86.

<sup>15</sup> Shih vendimet (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 15, datë 18.06.2021, paragrafët 23.7, 25.1 dhe 25.2; nr. 20, datë 14.06.2022, paragrafi 20.2.5.

konkluzionin lidhur me vërtetësinë e deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe mbështetur në qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, i vlerëson problematikat e konstatuara lidhur me këto shuma, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të këtyre problematikave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me analizën financiare për periudhën 10.12.2009 – 2016*

19. Komisioni, për analizën financiare për periudhën 10.12.2009 – 2016, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare, në vlerën (-) 512.285 lekë.
20. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë rezultat të Komisionit, duke pretenduar se përlllogaritjet e kryera prej tij, jo vetëm nuk përputhen me faktet dhe provat e administruara, por shkojnë drejt pasaktësive thelbësore, si në mosmarrjen parasysh të provave, ashtu edhe në keqlllogaritjen matematikore të kryer. Shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, për analizën financiare paraqiten si vijojnë: (i) pranimi vetëm i shumës 100.000 lekë nga çmimi i shitjes së automjetit “Honda Civic”, duke e konsideruar diferencën mes çmimit të shitjes dhe të blerjes, prej 350.000 lekësh, jashtë logjikës ekonomike, nuk qëndron. Nga ana tjetër, kjo shumë prej 100.000 lekësh nuk është përfshirë në vlerën e *cash*-it në analizën financiare të Komisionit. Argumenti i ndjekur prej tij nuk gjen mbështetje ligjore në nenin 22, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; (ii) pavarësisht se nuk është deklaruar si pakësim i *cash*-it në deklaratën periodike vjetore 2012, blerja e automjetit “Volkswagen”, në vlerën 700.000 lekë, nënkupton që ka dalje të mjeteve monetare ose pakësim të *cash*-it. Në këtë vit, janë kryer disa transaksione të mbështetura në kontrata shitjeje dhe blerjeje automjeti, dhe me ndryshimin e gjendjes së likuiditetit sipas tyre, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive; (iii) duhen rishikuar të ardhurat nëpërmjet një analize të plotë të tyre, përfshirë dietat dhe urdhërsërbimet; (iv) Komisioni ka dublikuar shpenzimet e jetesës, duke i përlllogaritur ato vjetore, pa zbritur ditët e vitit sipas shpenzimeve TIMS (kosto ushqimi, qëndrimi në Greqi).
21. Lidhur me automjetin “Honda Civic”, Komisioni, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë Shqipërisë me këtë automjet më shumë se 100 herë deri në momentin që e ka shitur. Shpjegimet lidhur me shërbimet e mirëmbajtjes, të pashoqëruara me dokumentacion provues, nuk janë vlerësuar të mjaftueshme për të justifikuar vlerën e shitjes së automjetit 3 herë më shumë, pas 6 (gjashtë) vitesh përdorim. Komisioni vlerëson se nuk ka asnjë logjikë ekonomike apo tregtare që kësaj pasurie t’i rritet vlera, duke pranuar vlerën e shitjes të jetë e barabartë me atë të blerjes, e duke llogaritur në analizën financiare shumën 100.000 lekë si të ardhur të ligjshme.
22. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, në analizë të shkaqeve ankimore të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton:
  - 22.1. Në deklaratën periodike vjetore 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen e automjetit “Volkswagen” më datë 04.04.2012, në vlerën 700.000 lekë dhe shitjen e automjetit “Honda Civic” më datë 13.07.2012, në vlerën 450.000 lekë. Kjo pasuri e luajshme është deklaruar për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës 2009.

22.2. Referuar dokumenteve të përcjella bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 06.02.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, automjeti “Honda”, tip “Civic”, fillimisht është blerë në Gjermani, më datë 23.12.2005, nga z. E. T., në vlerën 800 euro, dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 164.791 lekë. Më datë 03.08.2006, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., automjeti i shitet subjektit të rivlerësimit, në vlerën 100.000 lekë, të cilin pas 6 (gjashtë) vitesh, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.07.2012, subjekti ia shet z. M. D., në vlerën 450.000 lekë.

22.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me shpenzimet që kanë ndikuar në shitjen disa herë më shtrenjtë të automjetit “Honda Civic”, pas përdorimit për rreth 6 (gjashtë) vjet të tij, ndërkohë që, sipas Komisionit, në referim të nenit 22, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, amortizimi i aktiveve, përfshirë automjetet, është 20% në vit, subjekti i rivlerësimit sqaron se automjeti është blerë nga z. E. T. me çmim preferencial, pasi ka pasur vlerë disa herë më të lartë se 100.000 lekë, ku vetëm detyrimi doganor, pa llogaritur shpenzimet e transportit dhe të blerjes në Gjermani, ka qenë rreth 160.000 lekë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se me z. T., i cili kishte disa vjet që studionte e punonte në Gjermani, ka një marrëdhënie të veçantë shoqërore dhe shpirtërore, dhe është kumbar i martesës dhe pagëzimit të vajzës së tij<sup>16</sup>. Më pas, automjeti është shitur në vlerën 450.000 lekë, pikërisht për shkak të gjendjes shumë të mirë teknike, kushteve optimale, kilometrave të kryer, funksioneve ekstra, konsumimit të ulët të karburantit, si dhe shërbimeve të kryera e mirëmbajtjes së tij.

22.4. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit në ankim u qëndron shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ ku ka sqaruar se konstatimi i Komisionit që ky automjet duhet të kishte një amortizim rreth 20% në vit, nuk gjen mbështetje ligjore në nenin 22, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pasi ky nen u adresohet subjekteve apo njësive ekonomike fitimprurëse dhe në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk është subjekt tregtar, por individ, person fizik. Sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit<sup>17</sup> (SKK) 5, vlera e një aktivi është shuma e parave e paguar ose vlera e drejtë (tregu) për të blerë ose prodhuar një aktiv. Me vlerë të drejtë kuptohet çmimi në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut shitës dhe blerës në datën e ndodhjes së veprimit sipas dokumentacionit provues, si kontrata e shitjes ose fatura tatimore. Në vlerën e mbetur të aktivit ndikojnë përdorimi, konsumimi i parakohshëm, përparimi teknologjik, ndryshimet në çmimet e tregut dhe shërbimet apo mirëmbajtja e aktivit, që ndryshon jetën e dobishme dhe kohëzgjatjen e tij. Bazuar në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit insiston në pretendimin se vlera e automjetit duhet konsideruar 450.000 lekë, si specifikuar në kontratën e shitjes së tij.

---

<sup>16</sup> Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, depoziton: (i) “Vërtetim”, datë 23.05.2021, i Mitropolisë së Shenjtë Korçë, sipas të cilit Gentian Stoja është kumbar në kurorëzimin e z. Xh. T. me znj. I. S., si dhe është kumbar në pagëzimin e vajzës së tyre, A. T.; (ii) foto të ceremonisë së kurorëzimit.

<sup>17</sup> Në zbatim të nenit 5, pika 1 e ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 1, datë 25.6.2014, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara”, dhe shpalljes me urdhrin nr. 64, datë 22.07.2014, të ministrit të Financave “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.



22.5. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ka pasur detyrim ligjor për të mbajtur dokumentacion lidhur me investimet e kryera në automjetin “Honda Civic”, si dhe sjell në vëmendje se nocioni “shpenzim i deklarueshëm” është përcaktuar si detyrim për deklarim me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012<sup>18</sup>. Megjithatë, pavarësisht këtij pretendimi, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar qoftë me një dokument të vetëm shpenzimet e kryera për shërbime mirëmbajtjeje apo të tjera që të kenë shërbyer për rritjen me rreth 4,5 herë të vlerës së automjetit pas 6 vitesh përdorim, trupi gjykues, duke e konsideruar pa peshë arsyetuese në këtë rast referimin në nenin 22, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe marrëdhënien miqësore me shitësin, apo përfitimim e automjetit me çmim preferencial, për vetë natyrën e tregut të lirë të automjeteve dhe fleksibilitetin në rënien e çmimit të tyre pas përdorimit, konfirmon qëndrimin e Komisionit se mungon logjika ekonomike apo tregtare e rritjes së vlerës së kësaj pasurie në kushte të tilla. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat nga shitja e automjetit, në linjë me Komisionin, t’i konsiderojë në vlerën 100.000 lekë. Po ashtu, trupi gjykues gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se shuma prej 100.000 lekësh nuk është përfshirë në vlerën e *cash*-it në analizën financiare të Komisionit, pasi në tabelën e analizës financiare në faqen 38 të vendimit objekt shqyrtimi, vlera 100.000 lekë pasqyrohet në zërin “Të ardhura”, me emërtimin “Të ardhura nga shitja e automjetit “Honda””.

22.6. Lidhur me analizën financiare për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pavarësisht se nuk është deklaruar si pakësim i *cash*-it në deklaratën periodike vjetore 2012, blerja e automjetit “Volkswagen” në vlerën 700.000 lekë, nënkupton që ka dalje të mjeteve monetare ose pakësim të *cash*-it. Në përgjigjet e pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nga kursimet *cash* prej 15.000 eurosh, shuma 700.000 lekë është shpenzuar për blerjen e automjetit “Volkswagen”, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012. Trupi gjykues i Kolegjit gjen të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi, se edhe pse subjekti i rivlerësimit rezulton se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 15.000 euro para fillimit të detyrës në vitin 2009, në shpenzimin e kryer për blerjen e automjetit “Volkswagen” nuk ka konsideruar vlerën 700.000 lekë të pakësuar nga gjendja *cash* 15.000 euro, në kushtet kur nuk është deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie të luajtshme në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratën periodike vjetore 2012.

22.7. Në kuadër të kontrollit të analizës financiare të kryer në Komision për periudhën 2009 – 2016, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstaton se të ardhurat nga pagat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, Komisioni i ka konsideruar sipas të dhënave të ekstraktuara nga lëvizjet e llogarive bankare të tyre pranë Credins Bank ShA dhe Raiffeisen Bank ShA. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizë financiare të dietave dhe urdhërshërbimeve, pavarësisht qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën<sup>19</sup> e tij, se dietat janë vlera monetare të destinuara të përdoren për një qëllim specifik, për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre

---

<sup>18</sup> Ligji nr. 85/2012, datë 18.09.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

<sup>19</sup> Shih vendimin nr. 7, datë 05.04.2019, paragrafët 34, 36 dhe 39 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pra nuk përfshihen në të ardhura, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka përfshirë dietat jo vetëm sa shprehet në paragrafin 18.6 të vendimit, për vitin 2015, por për të gjithë periudhën 2009 – 2016. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, dietat dhe urdhërshebimet nuk janë përfshirë në zërin “Të ardhura”, por janë zbritur nga shpenzimet e jetesës për çdo vit të periudhës nën analizë. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit rezultojnë të jenë pranuar nga Komisioni dhe nuk duhet të ngriheshin si pretendim në Kolegj.

**22.8.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në përlllogaritjen e *shpenzimeve të jetesës* janë përfshirë të gjitha ditët e vitit, ndërkohë në zërin “Shpenzime TIMS”, Komisioni ka llogaritur kosto qëndrimi të cilat duhen zbritur nga shpenzimet e jetesës, pasi do t'i dublikonin ato, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arsyetuar në vendim se shpenzimet e jetesës janë shpenzime të minimumit jetik, ndërkohë që shpenzimet e kryera për udhëtime jashtë Shqipërisë janë shpenzime për turizëm, të deklaruara nga subjekti dhe ato të llogaritura në mënyrë hipotetike, mbështetur në referenca dhe kosto minimale. Në ndryshim nga Komisioni, i cili përdor në arsyetim termin “shpenzim i minimumit jetik”, trupi gjykues arsyeton se INSTAT-i, në shkresat e përcjella<sup>20</sup>, sqaron ILDKPKI-në se ky institucion nuk përcakton vlerën e minimumit jetik në Shqipëri, por llogarit shpenzimet mujore për konsum. Të dhënat për shpenzimet jetike të publikuara nga INSTAT-i, konsistojnë në vlerën e produkteve dhe shërbimeve për të plotësuar nevojat individuale të Njësisë Ekonomike Familjare, të cilat klasifikohen sipas Klasifikimit Evropian të Produkteve sipas Qëllimit (COICOP)<sup>21</sup>, i përshtatur për Anketën e Buxhetit të Familjes në kushtet e Shqipërisë. Struktura e shpenzimeve për konsum të Njësisë Ekonomike Familjare është e paraqitur sipas ndarjes në 12 grupe kryesore të konsumit, ku nuk rezultojnë të përfshira shpenzime për turizëm, pushime jashtë vendit etj. Në kushtet kur këto shpenzime nuk janë konsideruar pjesë e konsumit bazë, mbi të cilat INSTAT-i llogarit shpenzimet jetike, trupi gjykues vlerëson që ato të përlllogariten si nënzhë i shpenzimeve të kryera më vete.

**22.9.** Në mbështetje të arsyetimit më sipër, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 2009 – 2016, trupi gjykues konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në vlerën (-) 512.285 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 23.** Për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në ndryshim nga Komisioni, mangësitë e konstatuara lidhur me: (i) kursimin *cash* në vlerën 4.440.000 lekë; (ii) shumën në formë dhurate 50.000 euro, të deklaruar nga bashkëshortja në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009; (iii) automjetin “Honda Civic”; dhe (iv) mungesën e burimeve financiare të ligjshme, të konstatuar për periudhën 2009 – 2016, trupi gjykues nuk i gjen në atë nivel sa të çojnë në zbatueshmërinë e nenit 61, pika 3, e të përcaktimeve kushtetuese të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por i vlerëson ato në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve.

<sup>20</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019.

<sup>21</sup> Classification of Individual Consumption by Purpose.

### **C. Vlerësimi i Kolegjit mbi problematikat e konstatuara lidhur me kriteret e kontrollit të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale**

24. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se vendimmarrja e Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja, është bazuar jo vetëm në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por edhe në nenin 61, pika 5 e tij, që përcakton se: *Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.* Komisioni, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte, si: *balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.* Përveç problematikave me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar mangësi lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, të cilat, duke mos i konsideruar mjaftueshëm në atë nivel sa për të zbatuar përcaktimet e nenit 61, pikat 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, i ka vlerësuar në tërësinë e tyre për të arritur zbatueshmërinë e nenit 61, pika 5 e këtij ligji.
25. Nga analizimi i ankimit dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegj, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ankimuar problematikat e konstatuara nga Komisioni, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe disa sjellje e veprime rezultuar nga shqyrtimi i denoncimeve në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, me pasojë zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Aplikimi i kësaj dispozite përbën në vetvete një shkak shkarkimi të pavarur nga pamjaftueshmëria në deklarin e pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e këtij ligji. Në këto kushte, trupi gjykues, në zbatim të nenit 459, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, konsideron se subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë prej tyre. Për këtë arsye, konstatimet e Komisionit mbeten të pandryshuara dhe bëhen pjesë e analizës së Kolegjit, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tri kritereve.
26. Në kuadër të kontrollit të figurës, pas konstatimit për papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në raportin e DSIK-së, pasi ka hetuar lidhur me informacionin e klasifikuar vënë në dispozicion, si dhe denoncimet e depozituara nga publiku, të cilat ngrenë dyshime për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, ushtrim të ndikimit të paligjshëm në disa procese penale dhe të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni arriti në përfundimin *se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikave 2 apo 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por se konstatimet e gjetura gjatë hetimit, mund të vlerësohen nga Komisioni në vlerësimin në tërësi të çështjes, lidhur me rivlerësimin e subjektit Gentian Stoja, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
- 26.1.** Konkretisht, lidhur me përdorimin e automjetit “SAAB”, i cili nuk rezulton në pronësi të tij, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ky automjet ndodhet në garazhin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në cilësinë e provës materiale

dhe është përdorur prej tij dhe prej oficerit të policisë gjyqësore pranë ShÇBA<sup>22</sup>-së Korçë, vetëm për nevoja të ngutshme pune, për të mundësuar veprime procedurale me metoda speciale hetimi. Sa i përket pyetjes nëse ka pasur ndonjë akt përdorimi dhe autorizim për përdorimin e këtij automjeti dhe targat me të cilat ka lëvizur, subjekti ka sqaruar se ky automjet është sekuestruar në cilësinë e provës materiale në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2018, që është ende nën hetim prej tij dhe është përdorur vetëm në dobi të punës, në disa raste të veçanta për veprime operacionale për llogari të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, ende nën hetim prej tij, ku objekt hetimi kanë qenë punonjës të policisë së Drejtorisë Vendore Korçë. Automjeti, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur targa për të mos u identifikuar, me qëllim mbajtjen nën mbikëqyrje të sinkronizuar edhe me interceptimet telefonike në kohë reale, duke dhënë si rezultat arrestimin e punonjësve të policisë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë çështje, Komisioni në vendim është shprehur se subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetin tip “SAAB”, të sekuestruar në cilësinë e provës materiale në një procedim penal ende nën hetim, dhe për përdorimin e tij, duket se nuk ka pasur akt apo autorizim të përdorimit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e institucionit.

**26.2.** Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për përdorimin e automjetit me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor nga personat e përfshirë në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2020, në vlerësim të trupit gjykues, përveçse të paprovuara me dokumentacion, nuk janë bindëse dhe mbeten thjesht në kontekst deklarativ. Përpos sjelljes abuzive në përdorimin e automjetit të palës në procedim penal, subjekti i rivlerësimit do të gjendej në kushtet e shkeljes të rregullave të qarkullimit rrugor, në rast të një aksidenti automobilistik në kuadër të përgjegjësisë ndaj të tretëve dhe dëmtimit të automjetit në cilësinë e provës materiale në një procedim penal. Në kuptim të nenit 208, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale<sup>23</sup>, sekuestrimi i automjetit në cilësinë e provës materiale, kryhet me një vendim të arsyetuar të gjyqtarit ose prokurorit. Trupi gjykues vlerëson se në të njëjtat kushte, vetëm me anë të një vendimi të arsyetuar apo autorizimi mund të përdoret ky automjet për veprime hetimore. Prokurori duhet të respektojë ligjet dhe rregullat e zbatueshme dhe të pajiset me autorizimin e duhur nëse i nevojitet të përdorë automjetin e sekuestruar për qëllime ligjore, duke respektuar të drejtat e personave të përfshirë në procedimin penal. Përdorimi i paligjshëm i një prove mund të dëmtojë legjitimitetin e procesit penal dhe do të vinte në rrezik vetë provën dhe atë çfarë kërkohet të provohet nëpërmjet saj. Përdorimi i paautorizuar me një akt të arsyetuar i automjetit “SAAB”, i sekuestruar në kuadër të një procedimi penal, afekton ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

27. Në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, hetoi edhe denoncimet nga publiku. Edhe pse nuk konkludoi në një vlerësim për secilin denoncim të hetuar, nga një vlerësim i përgjithshëm i tyre dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me to, si dhe dokumentacionit të administruar në funksion të vlerësimit të tyre, Komisioni çmon se nga vlerësimi i përgjithshëm nuk janë konstatuar gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej tij, e cila mund

---

<sup>22</sup> Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

<sup>23</sup> Neni 208, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penal parashikon: “1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve”.

të çonte në një mungesë të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por se disa sjellje dhe veprime të subjektit të rivlerësimit mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin në tërësi të çështjes, lidhur me rivlerësimin e subjektit Gentian Stoja, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

28. Kolegji e gjen me vend të përmendë disa nga mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit lidhur me denoncimet, të cilat Komisioni nuk i ka gjetur të mjaftueshme për zbatimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe i ka konsideruar në vlerësimin në tërësi të çështjes.

28.1. Në funksion të hetimit administrativ, për të provuar informacionin e denoncimit anonim nr. {\*\*\*} prot., datë 17.12.2020, sipas të cilit nga dosjet penale të viteve 2015 dhe 2016, të shfuqizuara me vendim të drejtuesit të prokurorisë, provohen shkeljet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimet për pushimin e procedimeve penale, të cilat pasi janë prishur dhe dërguar në gjykatë, autorët janë dënuar me burgim, Komisioni administroi vendimet e drejtuesit të prokurorisë<sup>24</sup> për periudhën 2015 – 2016, nga ku rezultoi se subjektit të rivlerësimit i janë shfuqizuar 13 vendime nga drejtuesi i prokurorisë, nga të cilat 8 janë vendime pushimi të procedimit penal, 4 vendime mosfillimi të procedimit penal dhe 1 vendim për dërgim për gjykim të procedimit penal.

28.2. Nga analizimi i vendimeve të drejtuesit të prokurorisë, rezulton se shfuqizimi i vendimeve të marra nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjeve, për 11 nga 13 kallëzimet/procedimet penale, është bërë për arsye se hetimi i kryer është konsideruar i paplotë, vlerësim i gabuar i provave apo interpretim i gabuar i ligjit material e procedural penal. Nga aktet e depozituara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

28.2.1. Për dosjen penale që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit E. P., e cila është një nga 5 dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, parashikuar nga neni 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimet e marra nga subjekti i rivlerësimit “Për pushimin e çështjes penale” më datë 26.01.2016 dhe më datë 17.05.2016, janë shfuqizuar<sup>25</sup> nga drejtuesi i prokurorisë. Në vijim, prokurori që zëvendësoi subjektin e rivlerësimit në këtë çështje, disponoi me dërgimin e saj në gjykatë. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.07.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimtar me 2 vjet burgim, dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, vënien në provë të të pandehurit për një periudhë prej 18 muajsh me kusht që gjatë periudhës së provës, të mos kryejë vepër tjetër penale.

28.2.2. Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit

---

<sup>24</sup> Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2020.

<sup>25</sup> Me vendimet “Mbi shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015”, më datë 16.02.2016 dhe më datë 20.05.2016.

D. H., subjekti i rivlerësimit, më datë 20.10.2015, merr vendimin “Për pushimin e çështjes penale”. Pas shfuqizimit të këtij vendimi nga drejtuesi i prokurorisë, në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 14.06.2016, subjekti i rivlerësimit paraqet kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.10.2016, vendos deklarin fajtor të të pandehurit D. H. për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i vulave, stampave dhe formularëve” dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim.

**28.2.3.** Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit D. M., subjekti i rivlerësimit, më datë 20.10.2015, merr vendimin për pushimin e çështjes penale. Pas shfuqizimit të këtij vendimi nga drejtuesi i prokurorisë, në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 23.05.2016, subjekti i rivlerësimit paraqet kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.10.2016, vendos deklarin fajtor të të pandehurit D. M. për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i vulave, stampave dhe formularëve” dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2018, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi dhe në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit të kryejë punë në interes publik.

Lidhur me procedimet penale nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit sqaron se procedimet penale janë pushuar përkohësisht deri në mbërritjen e akteve të kërkuara me letërporosi nga shteti i huaj, praktikë e ndjekur edhe nga prokurorë të tjerë, për të mos mbajtur në dorë çështjen si ngarkesë të tepërt dhe në pamundësi për ta pezulluar pasi autori ishte i njohur. Vendimi i shfuqizimit, sipas subjektit, është bërë prej tij personalisht dhe është firmosur nga drejtuesi i prokurorisë. Pas dërgimit nga organet e huaja kompetente të akteve të kërkuara, dhe kryerjes së aktit të ekspertimit teknik, akuzat janë provuar plotësisht dhe procedimet janë dërguar për gjykim dhe të pandehurit janë dënuar. Ndodhur në këto kushte, vlerësimi për këto dy procedime penale nuk është përfshirë në vlerësimin në tërësi të çështjes.

**28.2.4.** Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për veprën penale “Mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S. Sh., me vendimin e datës 23.06.2016, subjekti i rivlerësimit vendos pushimin e çështjes penale. Ky vendim shfuqizohet më datë 02.09.2016, nga drejtuesi i prokurorisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.10.2016, vendos deklarin fajtor të të pandehurës S. Sh. dhe dënimin e saj me gjobë.

**28.2.5.** Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për veprën penale “Mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit D. P., me vendimin e datës 23.06.2016, subjekti i rivlerësimit vendos pushimin e çështjes penale. Ky vendim shfuqizohet më datë 02.09.2016, nga drejtuesi i prokurorisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2016, vendos deklarin fajtor të të pandehurit D. P. dhe dënimin e tij me gjobë.

Lidhur me procedimet penale nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, drejtuesi i prokurorisë, me shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, marrë nga subjekti i rivlerësimit, ngarkoi prokurorë të tjerë për ndjekjen e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pretendoi se qëndrimi i drejtuesit të prokurorisë është i gabuar dhe ai kishte disponuar drejt me pushimin e çështjes penale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

dhe Gjykata e Apelit Korçë<sup>26</sup>, për një rast të ngjashëm, kishin vendosur pikërisht me pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale në zbatim të nenit 66/c të Kodit Penal, arsyetim i njëjtë me atë të përdorur prej tij në vendimet e pushimeve për procedimet penale nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2016. Pavarësisht këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kundërshtuar vendimin e shfuqizimit të drejtuesit të prokurorisë dhe përveç specifikave të ndryshme që mund të kenë pasur këto procedime penale, për ato të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur dënimin me gjobë të të pandehurit, vendim që ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar.

**28.2.6.** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, viti 2016, referuar për veprat penale “Pushtimi i tokës” dhe “Vetëgjyqësia”, të parashikuara nga nenet 200 dhe 277 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit vendos mosfillimin e procedimit penal. Pas shfuqizimit të këtij vendimi nga drejtuesi i prokurorisë, me arsyetimin se veprimet hetimore nuk janë të plota dhe vendimi i paargumentuar, u regjistrua procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2016, dhe pas hetimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, i është bërë kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për gjykimin e çështjes penale për të pandehurin Z. C., i akuzuar për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Gjatë seancës gjyqësore, prokurori Gentian Stoja ka kërkuar pushimin e çështjes penale pasi vepra penale është amnistuar sipas ligjit nr. 141/2016, datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.01.2017, disponoi me pushimin e çështjes penale për këtë arsye.

**28.2.7.** Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për veprën penale “Dhunim i banesës”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit T. K., subjekti i rivlerësimit vendosi të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes. Vendimi u shfuqizua nga drejtuesi i prokurorisë, pasi ishte marrë në vlerësim të gabuar të provave dhe pa kryer një hetim të plotë. Po kështu, në vendimin e shfuqizimit, arsyetohet se subjekti i rivlerësimit nuk kishte specifikuar paragrafin e nenit 112 të Kodit Penal në të cilin bazohej akuza, dhe se faktet tregonin se nuk ishin konsumuar elemente të veprës penale “Dhunim i banesës”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal, por të “Vjedhjes” së mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134 dhe 22 të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të veprimeve hetimore, vendosi pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nga hetimi është provuar se janë konsumuar elemente të veprës penale 112, paragrafi 1 i Kodit Penal, pasi sipas tij nuk mund të aludohet *apriori* se shtetasi T. K. kishte hyrë në banesë për të vjedhur, pasi nuk ka marrë asnjë send dhe nuk ka kryer asnjë veprim ndaj sendeve familjare. Subjekti i rivlerësimit vendos pushimin, duke orientuar palët e dëmtuara të drejtohen me kërkesë në gjykatë në zbatim të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale.

**28.2.8.** Për procedimet penale: (i) nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, parashikuar nga neni 235 i Kodit Penal; (ii) nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal; (iii) nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për veprën

---

<sup>26</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.09.2016, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.05.2017, vendosi pushimin e çështjes penale që i përkiste procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016.

penale “Mashtrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, pas shfuqizimit të vendimit të subjekti i rivlerësimit për pushimin e çështjes penale, pas hetimeve të kryera përsëri prej tij, vendoset pushimi i çështjes penale. Për këto çështje penale, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se janë arkivuar nga drejtuesi i prokurorisë, nuk është administruar një dokument provues për këtë pretendim apo informacion i mëtejshëm për ecurinë e tyre dhe fakti nëse i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor.

**28.2.9.** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. V., subjekti i rivlerësimit, më datë 11.01.2016, ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është shfuqizuar nga drejtuesi i prokurorisë, si i pabazuar në prova e në ligj. Më pas, subjekti i rivlerësimit vendos pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2016. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.06.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur prishjen e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve sipas disponimeve të gjykatës në vendim. Pas kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të urdhërimeve të lëna nga gjykata, nga prokurori është konkluduar se ky procedim penal duhet pushuar për arsye se fakti i pretenduar nuk ekziston. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2018, vendosi mospranimin e kërkesës së Prokurorisë për pushimin e çështjes penale dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve, ndërkohë që Gjykata e Apelit Korçë disponon me ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2016.

**28.2.10.** Lidhur me materialin kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, më datë 25.01.2016, ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili shfuqizohet nga drejtuesi i prokurorisë më datë 08.02.2016, duke i vlerësuar veprimet verifikuese të paplota. Më datë 31.03.2016, prokurori i çështjes Gentian Stoja vendos për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2016. Për materialin kallëzues nr. {\*\*\*}/2015, subjekti i rivlerësimit vendos mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nuk ka elemente të ndonjë veprë penale. Ky vendim shfuqizohet nga drejtuesi i prokurorisë dhe urdhërohet regjistrimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Për këto procedime penale, nuk është administruar informacion dhe dokumentacion mbi ecurinë hetimore dhe gjyqësore të tyre.

**28.3.** Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit i ka quajtur të padrejta vendimet e drejtuesit të prokurorisë dhe në vlerësim të tij, për të gjitha çështjet e denoncuar në mënyrë anonime, provat sipas tij janë marrë në mënyrë ligjore, janë analizuar në mënyrë profesionale dhe konkluzioni i arritur ka qenë sintezë e analizës mbi rrethana fakti objektive thelbësore dhe jo hamendësime apo vlerësim i gabuar i tyre, interpretim i gabuar i ligjit material penal dhe atij procedural penal, sipas tij procedura vetëm zbatohet dhe nuk interpretohet. Të gjitha këto procedime/kallëzime penale, shpjegon subjekti i rivlerësimit, pas shfuqizimit të tyre nga drejtuesi i prokurorisë, përsëri janë lënë në fuqi ashtu siç subjekti i rivlerësimit ka vendosur që në fillim, me përjashtim të tri rasteve, procedimeve penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015, nr. {\*\*\*} të vitit 2016 dhe nr. {\*\*\*} të vitit 2016.



**28.4.** Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, konstaton që subjekti i rivlerësimit në asnjë rast nuk ka shprehur mosdakordësinë e tij me vendimin e drejtuesit të prokurorisë për shfuqizimin e vendimeve të marra prej tij, nëpërmjet ushtrimit të ankimit te Prokurori i Përgjithshëm, referuar urdhrit nr. 147, datë 09.05.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”<sup>27</sup>. Për më tepër, nën optikën e zgjidhjes së çështjes penale nga gjykata, pas shqyrtimit gjyqësor, për 4 nga 5 procedimet penale për të cilat është administruar vendimi gjyqësor (pa përfshirë ato që u përkasin procedimeve penale nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2015), përkatësisht nr. {\*\*\*}/2015, {\*\*\*}/2016, {\*\*\*}/2016, {\*\*\*}/2016, ka rezultuar që vendimi i shfuqizimit nga drejtuesi i prokurorisë ka qenë i drejtë dhe i bazuar. Ndërsa për 6 (gjashtë) kallëzimet/procedimet e tjera penale, pretendimet e subjektit të rivlerësimit (trajtuar më sipër) janë deklarative, pasi nuk ka paraqitur akte mbështetëse për sa referon.

**28.5.** Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me denoncimet, duket se ai ka dështuar të provojë të kundërtën e barrës së provës, dhe në disa nga këto praktika, trupi gjykues konstaton si vijon.

**28.5.1.** Lidhur me denoncimin e z. H. K., subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se përse vendimi i mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}/2018, i marrë prej tij më datë 23.05.2018, i është dërguar kallëzuesit, në këtë rast denoncuesit, më datë 31.10.2018, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., pra mbi 5 muaj me vonesë. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, dhënë në Komision, subjekti i rivlerësimit sqaron se si praktikë pune, pasi studiohen aktet dhe merret vendim nga prokurori i çështjes, materiali hetimor i kalon sekretarisë përkatëse, e cila duhet të bëjë dhe njoftimet përkatëse. Për këtë rast, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ka dijeni për arsyen e vonesës së njoftimit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka afektuar indikatorin e aftësisë organizative për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore, që sipas parashikimit të nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, matet edhe nga përfshirja në mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

**28.5.2.** Lidhur me denoncimin e znj. F. M. për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i akteve të dosjes, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë 18.09.2018, vendos mosfillimin e procedimit penal, në lidhje me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2018, me arsyetimin se pretendimet e kallëzueses janë të karakterit civil e lidhen me zgjidhjen e mbivendosjes së pronës dhe gjykata, sipas tij, ka detyrimin ligjor që nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton elemente të veprës penale të konsumuar nga punonjësit që ushtrojnë funksione publike ose shtetas të ndryshëm, të referojë aktet në prokurori. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pas ankimit të kallëzueses znj. F. M., me vendimin {\*\*\*}, datë 15.11.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedimin penal për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal

---

<sup>27</sup> Në paragrafët 6 dhe 6.1 të urdhrit nr. 147, datë 09.05.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, parashikohet se: “Prokurori mund të bëjë ankim te Prokurori i Përgjithshëm, në rastet kur nuk është dakord me qëndrimin e drejtuesit të prokurorisë ose të prokurorit më të lartë. Ankimi shqyrtohet brenda dhjetë ditëve nga marrja njoftim, duke i kthyer përgjigje prokurorit ankues”.

dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas arsytimit në vendimin gjyqësor. Vetëm pas kryerjes së hetimeve, sipas gjykatës, prokurori mund të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq, në rast se do të rezultojë ekzistenca e veprave penale dhe autori konkret, ose pushimin e çështjes (kërkesë në gjykatë për pushim), në rast se do të rezultojë që nuk ekzistojnë këto vepra penale.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.01.2019, në të cilin, ndër të tjera, shprehet se: *sikurse dhe Gjykata e Shkallës së Parë, vëren që konkluzioni i arritur nga organi i akuzës lidhur me mungesën e elementeve të veprës penale “Falsifikim i dokumenteve” apo “Shpërdorim i detyrës”, të kallëzuara nga kërkuesja, është i pambështetur dhe nuk mund të arrihej vetëm me një shqyrtim sipërfaqësor, referuar veprimeve procedurale të kryera, pa kryer hetime të mëtejshme, si rezultat i të cilave do të arrihej në një përfundim të saktë nëse fakti i referuar dhe ngjarja e ndodhur përmban ose jo elemente të ndonjë veprë penale.*

**28.5.3.** Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, sjellë në procesin e rivlerësimit nga denoncimi i z. V. N., njëherësh kallëzues në këtë procedim penal, rezulton se fillimisht ky procedim është regjistruar dhe hetuar nga prokurori J. K., i cili më datë 20.09.2017, kërkoi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pushimin e kësaj çështjeje penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2017, ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2018, vendosi kthimin e akteve të çështjes penale, duke urdhëruar prokurorin të vazhdojë hetimet sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese, të kryejë veprime të tjera hetimore, si dhe vazhdimin e hetimeve për rrethana të tjera të pahetuara. Me kthimin e akteve, procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2017, u hetua nga subjekti i rivlerësimit, i cili po ashtu kërkoi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë pushimin e procedimit penal. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, shprehet se hetimet nga subjekti i rivlerësimit nuk janë kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese, sipas drejtimit të thelluar të përcaktuar në vendimet gjyqësore të sipërpërmendura, të cilat janë të detyrueshme për t'u respektuar nga organi i prokurorisë. Shumë aspekte, sipas Komisionit, kanë mbetur pa hetuar në tërësi, dhe kërkesa për pushimin e procedimit penal është bazuar vetëm në interpretim të ligjit. Komisioni i ka kaluar barrën e provës, duke kërkuar shpjegime për sa më sipër, si dhe arsyet e zgjatjes së afateve të hetimit dhe mosnjoftimit e kallëzuesit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit jep sqarime mbi arsyet e zgjatjes së afateve të hetimit dhe faktin e mosnjoftimit të z. N. pasi në bazë të nenit 324, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, ai nuk kishte statusin e të dëmtuarit. Aktet e prokurorit, sipas subjektit të rivlerësimit, i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor për vlefshmërinë ose jo të tyre dhe në rastin konkret, nuk ka asnjë vendimmarrje të gjykatës për sa pretendohet nga kallëzuesi.

Nga analizimi i shqyrtimit gjyqësor të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2019, vendosi mospranimin e kërkesës së prokurorit Gentian Stoja, për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë regj. 21.06.2017, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe kthimin e akteve të procedimit penal për vazhdim të hetimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda dy muajve nga marrja e këtij vendimi formë të prerë, e të thellohen sipas drejtimit të përcaktuar nga gjykata në vendim. Gjykata e Apelit Korçë, pas ankimit të ushtruar nga prokurori, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2019, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Korçë, ndër të tjera, arsyeton se: [...] *vlerëson të drejtë*

*qëndrimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila ka çmuar që në rastin konkret, nuk është kryer hetim i plotë dhe i gjithanshëm për të arritur në përfundimin që çështja penale në ngarkim të shtetasit S. D., e regjistruar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duhet të pushohet. Hetimi i kryer dhe kërkesa e organit të akuzës për pushimin e çështjes penale nuk u kanë dhënë përgjigje problematikave të lindura gjatë hetimit të çështjes dhe të evidentuara në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2018, të Gjykatës së Apelit Korçë, në të cilin janë lënë detyra konkrete për sa i përket kryerjes së hetimeve të thelluara, me qëllim verifikimin e pretendimeve të parashtruara në kallëzimet e shtetasve A. J. dhe V. N.. [...] Organi i akuzës, duke i qëndruar interpretimit të bërë dhe në kërkesën e parë për pushimin e çështjes datë 20.09.2017, ka anashkaluar urdhërimet dhe orientimet e dhëna nga të dyja gjykatat për veprime shtesë ose për të interpretuar rezultatet e këtyre veprimeve. Ecuria e mëtejshme hetimore apo zgjidhja në themel e çështjes nga gjykata, në vlerësim të trupit gjykues, nuk shëron mangësitë e treguara nga subjekti i rivlerësimit në plotësimin e detyrave të lëna nga gjykata për organin e akuzës.*

**28.6.** Në rastin e sjellë në vëmendje nga denoncuesja Xh. Q., provohet që vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit për mosfillimin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2019, i është nënshtruar kontrollit gjyqësor, dhe është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2020, e cila ka urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas drejtimit të përcaktuar prej saj në vendim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.01.2021, në të cilin arsyeton se nuk ndodhet përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Pavarësisht konfliktit e gjykimit civil, në kushtet kur kallëzuesja pretendon se ekzistojnë dy vepra penale, të tilla si “falsifikimi i dokumenteve” dhe “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, duke sqaruar se cilat dokumente pretendohen të falsifikuara dhe cilat veprime të punonjësve të ASHK, Drejtoria Vendore Korçë përbëjnë shpërdorim detyre, prokuroria, sipas gjykatës, ka detyrimin ligjor të hetojë në lidhje me to. Verifikimi i faktit të pretenduar nga kallëzuesja për falsifikimin e skicës së pronës, sipas vlerësimit të gjykatës, nuk mund të kryhet nga vetë prokurori, por është e nevojshme që të merret mendim nga ekspertët e licencuar të fushës përkatëse.

**28.7.** Trupi gjykues, konstatimet në formën e mangësive të përsëritura të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e veprimeve hetimore dhe marrjen e vendimeve të mosfillimit apo pushimit të procedimeve penale, të analizuara në kuadër të indikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pika 2 dhe neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, së bashku me përdorimin e automjetit të sekuestruar, i vlerëson në drejtim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

- 29.** Për sa më sipër, mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, së bashku me problematikat e konstatuara nga Komisioni për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, u vlerësuan në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe e çuan trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, në përputhje me parashikimet e nenit 61, pika 5 e këtij ligji. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 395, datë 08.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 395, datë 08.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Stoja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.07.2023.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*